

V E N D I M
Nr.30, datë 16.1.2003

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË “TRANSNAFTA”, SHPK, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe të ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria “Transnafta” shpk, Patos, t’i nënshtrohet procesit të privatizimit. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë transferimi i së drejtës të pronësisë të pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të saj, të tretëve.

2. Struktura e formulës së privatizimit për transferimin e së drejtës së pronësisë të pjesëve të barabarta të kapitalit të shoqërisë të jetë si më poshtë vijon:

a) Jo më pak se 51 për qind e pjesëve të barabarta të kapitalit të ofrohen për t’u shitur në lekë. Sasia e mësipërme e pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të transferohet nëpërmjet shitjes në ankand.

b) Ish-pronarëve të truallit t’u ofrohen pjesë të barabarta të kapitalit, të përllogaritura sipas vlerës së këtij trualli të përfshirë në kapitalin themeltar të shoqërisë, në mbështetje të akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi.

c) Punonjësve të shoqërisë u ofrohen pjesët e barabarta të kapitalit në shkëmbim të vlerës së bonove të privatizimit, të dhëna nga shteti. Madhësia e kësaj pakete nuk mund të jetë më e madhe se 20 për qind e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Punonjës të “Transnafta” shpk, Patos, quhen punonjës të efektivë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe punonjës të kësaj shoqërie, të dalë në asistencë, me vendimet nr.422, datë 9.7.1998 e nr.372, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave.

3. Procedurat e privatizimit të shoqërisë të bëhen në mbështetje të vendimit nr.119, datë 18.3.2000, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”.

4. Formula e privatizimit të paketave të pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të shoqërisë, të përcaktohet me urdhër të ministrit të Ekonomisë.

5. Ngrkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano